



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Numri i lëndës: 2024:117031
Datë: 25.07.2024
Numri i dokumentit: 05983082

K.Dh.Sh II.nr.881/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Departamenti i Përgjithshëm, Dhoma e shkallës së dytë, me gjyqtaren Franciska Zhitija Ymeri në çështjen përmbartimore të kreditorit N.P.SH “Smart Project”, me NRB:70275674, me seli në Prishtinë, rruga e “Ganimete Tërbeshi” nr.25, kundër debitorit N.SH “Piccolo”, me NRB:70300574, me seli në Gjakovë, me bazë juridike përmbartimore, duke vendosur lidhur me ankesën e të autorizuarit të kreditorit, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhoma e Shkallës së Parë-Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.732/23 të datës 18.12.2023, me datë 25.07.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e kreditorit N.P.SH “Smart Project”, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhoma e Shkallës së Parë-Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr. 732/23 të datës 18.12.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale të Kosovës, Dhoma e Shkallës së Parë-Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr. 732/23 të datës 18.12.2023, në dispozitiv e ka pranuar në tërësi si të

bazuar prapësimin e debitorit N.SH “Piccolo të ushtruar kundër Urdhrit për Përmbarim P.nr. 185/23, të dt. 12.04.2023, të Përmbaruesit Privat Gjoke Radi dhe i njëjti Urdhër për përmbarim Përfundohet.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë i autorizuari i kreditorit, (*me pretendime sikur në ankesë*), me propozim, të aprovoj ankesën si të bazuar dhe të anulohet aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës Dhoma e Shkallës së Parë - Departamenti Ekonomik, KPPP.nr. 732/23 të datës 18.12.2023, dhe lënda të kthehet në rivendosje.

Debitori nuk ka ushtruar përgjigje në ankesë

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e kreditorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori N.P.SH “Smart Project”, me datën 12.04.2023, ka paraqitur propozimin për përmbarim mbi bazën e dokumentit të besueshëm, dokumentit të besueshëm – Faturës Nr.01/23 të datës 17.03.2023, me të cilin e ka detyruar debitorin që në emër të përmbushjes së borxhit nga faturat më sipër, t’ia paguaj shumën e përgjithshme prej 22,902.50 €, me kamat ligjore 8% nga dita e lejimit të përmbarimit e deri në pagesën e fundit, si dhe të gjitha shpenzimet e procedurës përmbarimore që do të krijohen, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm, ashtu që përmbarimi të bëhet përmes bllokimit të llogarive bankare të debitorit, si dhe me regjistrimin, konfiskimin dhe shitjen e sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme në pronësi të debitorit deri në arritjen e borxhit në tërësi Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor e ka kundërshtuar urdhrin përmbarimor, duke theksuar se debitori me kreditorin kanë pasur marrëveshje për hartimin e projektit kryesor për ndërtimin e objektit afariste banesor, debitori me rastin e nënshkrimit të kontratës i ka paguar kreditorit me para në dorë shumën prej 5,000.00 €, ndërsa përmes transferit bankar i ka bërë edhe pagesën në shumë prej 10,000.00 €. Tutje ka theksuar se kreditori akoma nuk i ka dorëzuar projektin lidhur me pengesat eventuale për detyrimet kontraktore për aplikim në drejtorinë e Urbanizmit në Prishtinë për marrjen e lejes

së ndërtimit, andaj mbi bazën e kësaj debitori e ka kundërshtuar në tërësi borxhin që kërkohet sipas urdhrit përmbartimor. I ka propozuar gjykatës që të pezullohet procedura përmbartimore, të hedhet poshtë Urdhri Përmbartimor P.nr.185/23 i datës 12.04.2023, si dhe të detyrohet kreditori t'ia paguaj shpenzimet e procedurës përmbartimore. Kreditori në përgjigje në prapësim, ka deklaruar se e konteston në tërësi si të pabazuar prapësimin e parashtruar nga debitori, duke theksuar se nuk qëndrojnë deklaratimet e debitorit pasi që kreditori nuk ka pranuar asnjë ankesë, vërejtje mbi neglizhimin apo ngadalësimin e zhvillimit të projektit, kreditori projektin në fjalë e ka përfunduar me kohë dhe brenda afatit të përcaktuar i janë dorëzuar debitorit. Tutje ka theksuar se debitori nuk ka filluar ndërtimin për shkak të mosmarrëveshjeve me pronaret e tokave dhe jo për shkak të mos dorëzimit të projektit nga ana e kreditorit. Po ashtu ka theksuar se fatura e bashkëngjitur urdhrit për përmbartim i përmban të gjitha elementet e dokumentit të besueshëm. Gjykatës i ka propozuar që të refuzohet si i pabazuar prapësimi i debitorit, ndërsa Urdhri Përmbartimor të mbetet në fuqi.

Gjykata e shkallës së parë pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes së kreditorit në prapësim, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës dhe, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, (tutje LPP) dhe nenit 12 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 Për Procedurën Përmbartimore, gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe se urdhri përmbartimor duhet të anulohet dhe procedura përmbartimore të përfundohet në tërësi për shkaqet si në vijim: Gjykata ka vlerësuar se në rastin konkret fatura në bazë të së cilës është lejuar urdhri për përmbartim, nuk i plotëson kushtet e parapara me nenin 29 dhe nenin 37 të LPP-së. Sipas nenit 29 paragrafit 1 të LPP-së, përcaktohet se “Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm” dhe me paragrafin 3 të njëjtit nen, përcaktohet se “Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”, ndërsa me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se “Kur propozimi për përmbartim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t'i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit”.

Në arsyetim të aktvendimit të ankimuar gjykata e shkalla e parë, fillimisht ka vlerësuar faturat Nr.01/23 e datës 17.03.2023, në bazë të së cilës është lejuar propozimi për përmbartim nuk i

plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm, për faktin se fatura në rastin konkret është lëshuar në mënyrë të njëanshme nga ana e kreditorit dhe nuk është pranuar nga debitori, përkatësisht nuk përmban nënshkrimin e as vulën e pranuesit - debitorit dhe nuk ka dëshmi se të njëjtat janë pranuar nga debitori. Meqenëse debitori nuk ka pranuar në mënyrë të rregullt faturën e lartcekur, si e tillë nuk mund të shërbejë si dokument i besueshëm dhe nuk ka tipare të përmbarueshmërisë, përderisa njëra palë procedurale - debitori nuk ka pranuar një detyrim që rrjedh nga fatura.

Gjykata Komerciale vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj konkludimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata Komerciale, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i ankimuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Gjykata Komerciale, Dhoma e shkallës së dytë, vlerëson se në rastin konkret kemi të bëjmë me propozim për përmbarim, në bazë të dokumentit të besueshëm-faturës ku me dispozitën e nenit 29 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore nr.04/L-139, përcaktohet se përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet në bazë të dokumentit të besueshëm dhe se dokument i besueshëm sipas LPP-së është: Fatura. Dokumenti i besueshëm, është i përshtatshëm për përmbarim po që se në të është treguar kreditori dhe debitori si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar, e në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me dokumentet të besueshme, pasi që e njëjta nuk është nënshkruar nga ana e debitorit dhe si të tilla nuk paraqesin bazë juridike për caktimin e përmbarimit në kuptim të dispozitës së nenit 21 të LPP-së.

Dhoma e Shkallës së dytë gjeti se Fatura 01/23 e datës 17.03.2023 në bazë të së cilës është lejuar përmbarimi nuk i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm sipas nenit 29.3 të LPP-së, për faktin se në rastin konkret nuk mund të vërtetohet që fatura është pranuar në mënyrë të rregullt nga debitori, duke qenë se fatura nuk përmban nënshkrimin apo vulën e biznesit të debitorit, edhe pse pretendimet e kreditorit se fatura së bashku me njoftimin për mos pagesën e borxhit është dërguar përmes postës, gjë e cila vërtetohet nga fletëkthesa e datës

20.02.2023, mirëpo nga përshkrimi në fletëkthesën e datës 20.02.2023, rezulton se debitorit nga ana e kreditorit i është dërguar “Kërkesë për Pagesën e Detyrimit-Borxhit 22,902.5 € +18% TVSH”, ndërsa në përshkrim nuk evidentohet se i është dërguar Fatura nr.01/23 e datës 17.03.2023, andaj nuk mund të konsiderohet se është pranuar në mënyrë të rregullt.

Kjo gjykatë vlerësoj të gjitha pretendimet ankimore por të njëjtat nuk kishin ndikimi në vendosje ndryshe në këtë çështje përbarimore, andaj dhe i refuzoj si të pa bazuar.

Po ashtu Dhoma e Shkallës së dytë është e qëndrimit se në procedurën përbarimore organi përbarues, përfshirë këtu edhe gjykatën që ka kompetencë shqyrtimin e ligjshmërisë së përbarimit, nuk ka tagër të vlerësojë ligjshmërinë e raportit juridik nga i cili rrjedh dokumenti i besueshëm, statusin e palëve apo detyrimet e ndërsjella mes tyre. Por, organi përbarues, përfshirë edhe gjykatën e shkallës së parë shqyrton vetëm rregullsinë dhe përshtatshmërinë e dokumentit përbarues dhe/apo atij të besueshëm, me ç’rast procedura sipas prapësisimit i nënshtrohet vetëm shqyrtimit formal të titullit ekzekutiv.

Dhomat e Shkallës së Dytë pas analizimit të shkresave të lëndës vërejt se në rastin konkret urdhri mbi lejimin e përbarimit P.nr. 185/23 të datës 12.04.2023, është nxjerrë pa u plotësuar kushtet për lejimin e tij, ngase propozimit për përbarim për faktin se fatura nuk përmban nënshkrimin apo vulën e biznesit të debitorit dhe nuk i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm sipas nenit 29.3 të LPP-së,

Po ashtu, kjo gjykate vlerëson se palët ndërgjyqëse mund të iniciojnë procedurë në gjykatën kompetente, për ti provuar pretendimet e tyre rreth mos përmbushjes së detyrimeve që dalin nga fatura respektive , në këtë fazë, duke pasur parasysh çështjet kontestuese të lartcekura, si të tilla, janë të pa përshtatshme për përbarim, siç me të drejtë konstatoj edhe gjykata e shkallës së parë.

Andaj, nga të cekurat kjo gjykatë vlerësoj se aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë duhet vërtetuar dhe të refuzohet ankesa e kreditorit si e pathemeltë.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 77 dhe 17 të LPP-së, lidhur me nenin 208 dhe 209, pika b), të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS-Dhoma e shkallës së dytë

K.DH.SH.II.nr.881/24, me datë 25.07.2024

Gjyqtarja,
Franciska Zhitija Ymeri